



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

Nr.

Prot.

13034/1

Tiranë, më 10/07/2020

**UDHËZIM PLOTËSUES**

Nr. 27 Datë 10/07/2020

**“PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM VENDOR  
2021-2023”**

Në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Ministri i Financave dhe Ekonomisë:

**UDHËZON:**

Ky udhëzim përmban:

- I. Afatet për përgatitjen dhe miratimin e tavanëve përfundimtare të përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023;
  - II. Transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
  - III. Proceset për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023;
  - IV. Ndjekja e Procesit dhe Mbështetja Këshillimore
  - V. Të tjera
- I. Afatet për përgatitjen dhe miratimin e tavanëve përfundimtare të përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023**
1. Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.
  2. Raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve përmban të dhënat për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme buxhetore.
  3. Në këtë raport përfshihet:
    - a) metodologjia e përdorur për parashikimin;
    - b) analiza e efekteve të politikave të reja fiskale ose ndryshimit të atyre ekzistuese; dhe
    - c) analiza e risqeve dhe masave për përballimin e tyre.

4. Tavanet Përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023 për çdo program, miratohen nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 20 Korrik 2020.
5. Jo më vonë se 5 ditë pas miratimit të taveve përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2021-2023 nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes vendore kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.
6. Udhëzimi i Brendshëm i Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore përmban:
  - a. Listën e programeve buxhetore dhe përcaktimin e ekipeve përkatëse të menaxhimit të programeve;
  - b. Tavanet Përfundimtare të PBA 2021-2023 për çdo program, për tre vitet e ardhshme buxhetore.
  - c. Afate të detajuara për Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për përgatitjen e kërkesave të shpenzimeve sipas programeve të PBA-së 2021-2023.
7. Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve (EMP), paraqesin kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Kordinatorit të GMS, brenda datës 31 gusht 2020.
8. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 15 Shtator 2020 duhet të dërgojë me shkrim dhe në rrugë elektronike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dokumentin përfundimtar të PBA 2021-2023, të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar dhe shtojcave të këtij udhëzimi.
9. Ministria e Financave dhe Ekonomisë zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 tetor.
10. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, analizon dhe përgatit një raport me rekomandime sipas rastit mbi dokumentin përfundimtar të PBA 2021-2023 dhe ja dërgon zyrtarisht njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 20 Tetor.
11. Kryetari i NJVQV-së paraqet pranë këshillit të NJVQV-së, dokumentin përfundimtar të PBA 2021-2023 dhe projektbuxhetit vjetor, të miratuar nga Grupi për Menaxhim Strategjik, së bashku me raportin me rekomandime të realizuara sipas rastit nga Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, jo më vonë se data 30 nëntor 2020.
12. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore shqyrton dhe miraton dokumentin përfundimtar të PBA 2021-2023 dhe projektbuxhetin vjetor brenda datës 25 dhjetor 2020.
13. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 31 dhjetor 2020, merr masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të plotë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe buxhetin vjetor, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tyre.
14. Njësitë e vetëqeverisjes vendore në hartimin e programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2021-2023 dhe për përcaktimin e nivelit të pagave duhet të bazohen në kuadrin ligjor të miratuar gjatë vitit 2020.
15. Manaxhimi i brendshëm i Proçesit të përgatitjes së PBA-së brenda NJVQV-së bazohet në mbledhjet e Grupit për Menaxhim Strategjik dhe mbledhjet e secilit prej Ekipeve të Manaxhimit të Programeve (EMP).

## **II. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për njësitë e vetëqeverisjes vendore**

16. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transferata e pakushtëzuar sektoriale për periudhën 2021-2023 do të jetë në përputhje me nivelin e financimit të miratuar në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2021-2023.
17. Niveli i transfertës së pakushtëzuar dhe i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitet 2021-2023, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin 2020. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar/pakushtëzuar sektoriale do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës financiare përkatëse.
18. Transfertat e pakushtëzuara të përgjithshme dhe sektoriale janë parashikuar në përputhje me përcaktimet e treguesve makroekonomikë sipas përcaktimeve dhe të e nenit 24, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
19. Të dhënat sasiore (numri i popullsisë, të ardhurat nga taksat për kapacitetin fiskal etj) për përllogaritjen e transfertës së pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, do të bazohen në treguesit e përdorur për përllogaritjen e transfertës së pakushtëzuar të vitit 2020.

### **III. Proceset për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023**

#### **3.1 Dokumente që duhen marrë në shqyrtim gjatë përgatitjes së tavaneve përfundimtare të PBA 2021-2023**

- a) Udhëzimet e MFE dhe Udhëzimi i Brendshëm i NJVQV-së për përgatitjen e PBA Vendor 2021-2023;
- b) Plani Strategjik i Zhvillimit/Plani i Përgjithshëm Vendor;
- c) Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal;
- d) etj.

#### **3.2 Instrumenti i Planifikimit Financiar**

20. Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023 do të përgatitet nëpërmjet Instrumentit të Planifikimit Financiar (bashkëlidhur udhëzimit).
21. Pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në drejtorinë përgjegjëse për financat vendore do të ofrohet shërbimi i asistencës në ndihmë të të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore në plotësimin dhe përdorimin e Instrumentit të Planifikimit Financiar.

#### **3.3 Formatet e kërkuara për raportim**

22. Pjesë e dokumentacionit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 që duhet dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si edhe në Këshillin Bashkiak janë vetëm formatet output, të cilat gjenerohen nga Instrumenti i Planifikimit Financiar dhe formati i kërkesave buxhetore në nivel produkti sipas programeve. Këto formate duhen dërguar të printuara/nënshkruara nga Kryetari i NJVQV-së dhe DEMP (sipas rastit).
  - Formatet nga F1- F16;
  - Formati B1 dhe B2 “Numri i punonjësve”;
  - Formati C6 “ Lista emërore e projekteve të investimeve”;

- Relacion shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (Shtojca 2, Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023);
  - Format i kërkesave buxhetore në nivel produkti sipas programeve.
23. Njëkohësisht, një kopje elektronike e të gjithë Instrumentit të Planifikimit Financiar duhet dërguar me email në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në adresat elektronike të paraqitura në seksionin IV të këtij udhëzimi.

#### **IV. Ndjekja e Procesit dhe Mbështetja Këshillimore**

24. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, vë në dispozicion për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, adresat e e-mailit: [Fran.Brahimi@financa.gov.al](mailto:Fran.Brahimi@financa.gov.al), [Elidona.Durmishi@financa.gov.al](mailto:Elidona.Durmishi@financa.gov.al), [Marisel.Frroku@financa.gov.al](mailto:Marisel.Frroku@financa.gov.al).
25. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund ti drejtohen në çdo kohë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zgjidhjen e çdo problematike që shfaqet në lidhje me hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe plotësimin e Instrumentit të Planifikimit Financiar.
26. Nëpunësi i parë autorizues, nëpërmjet njësisë përgjegjëse për buxhetin vendor analizon kërkesat buxhetore të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe zhvillon takime konsultative me këto njësi sipas një kalendari të paracaktuar. Takimet me njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë në fokus kërkesat buxhetore të lidhura me financimin e buxhetit qendror për vetëqeverisjen vendore.

#### **V. Të tjera**

27. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në përgatitjen e tavaneve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 duhet të mbajnë në konsideratë situatën e vështirë financiare të krijuar nga COVID-19, në planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.
28. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duhet të përfshijnë në Programin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 planin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.
29. Instrumenti i Planifikimit Financiar, manuali shpjegues i tij, formati i përgatitjes së relacionit shoqërues së programit buxhetor afatmesëm 2021-2023, mund të shkarkohen në linkun: <http://www.financa.gov.al/buxheti-i-pushtetit-vendor/>.

